

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
Prishtinë / Kosovë

Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit të pavarur
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për menaxhmentin e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (Organizat), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në fonde dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).

Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat

financiare Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrolle të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdohë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkakuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka
Auditor ligjor

Baker Tilly Kosovo
Prishtina, Kosovo

18 mars 2021



[Signature]
bakertilly
Baker Tilly Kosovo L.L.C.
Prishtinë

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
PAQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2020
 (Të gjitha shumat në Euro)

Me 31 dhjetor		2020	2019
	Shënime		
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Pajisjet dhe automjetet	3	22,131	29,816
Gjithsej Asetet jo-qarkulluse		22,131	29,816
Asetet qarkulluese			
Parapagime	4	411,307	411,307
Grantet e parapaguara	5	432,264	586,469
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	1,523,306	934,695
Gjithsej Asetet qarkulluese		2,366,876	1,932,471
GJITHSEJ ASETET		2,389,007	1,962,288
FONDI DHE DETYRIMET			
FONDI			
Bilanci i fondeve 01 janar 2020		441,122	452,633
Teprica / Deficiti I vitit		(7,686)	(11,511)
Gjithsej fondi		433,436	441,122
DETYRIMET			
Llogari të pagueshme dhe detyrimet tjera afatshkurta	7	47,760	46,037
Të hyrat e shtyra	8	1,907,810	1,475,128
Gjithsej Detyrimet		1,955,570	1,521,166
GJITHSEJ DETYRIMET DHE FONDI		2,389,007	1,962,288

Këto pasqyra financiare u aprovuan dhe u nënshkruan më datë 05 mars 2021, në emër të menaxhmentit nga:

Taulant Hoxha
 Drejtor Ekzekutiv

Edona Haliti,
 Drejtoresh e Financave dhe
 Administratës

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 13 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
 (Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2020	2019
	Shënime		
Të hyrat			
Kontributet dhe grantet	9	1,450,065	1,784,348
Të hyrat tjera	10	33,749	24,312
Gjithsej të hyrat		1,483,814	1,808,660
Shpenzimet			
Shpenzimet e projekteve	11	(491,181)	(467,273)
Shpenzimet e projekteve - Grantet	11	(662,352)	(1,000,601)
Shpenzimet Administrative	11	(30,568)	(36,023)
Shpenzimet tjera	11	(299,712)	(304,763)
		(1,483,814)	(1,808,660)
Rregullimet për pasuritë fikse	3	(6,065)	(1,720)
Shpenzimet e zhvlersimit	3	13,751	13,231
Gjithsej shpenzimet		(1,491,500)	(1,820,171)
Teprica (deficit) neto		(7,686)	(11,511)

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 13 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre